



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 673/3 Prot

Tiranë, më 23.09.2021

**V E N D I M**

Nr.116, datë 23.09.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Njësisë Përgjegjëse (DAP), për skualifikimin e aplikantes \*\*\*\*\* , nga pjesëmarrja në konkurrimin e shpallur me kod #3625.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet e ngritura nga nëpunësja \*\*\*\*\* për skualifikimin e aplikantes \*\*\*\*\* , nga pjesëmarrja në konkurrimin e shpallur me kod #3625.

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës protokolluar me nr. 673 prot, datë 16.06.2021, paraqitur nga punonjësja \*\*\*\*\* , është ngritur pretendimi se në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, kjo nëpunëse aktualisht mbajtëse e pozicionit “Specialiste e Funksioneve të Deleguara në sektorin e Monotorimit të Kompetencave Vendore dhe funksioneve të deleguara” në Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë, është skualifikuar pa të drejtë nga konkurrimi, në shpalljen me kod #3625, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë – Kategoria III-b.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III “Proçedura paraprake”, të Rregullores “Mbi proçedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kërkuar informacion Departamentit të Administrates Publike, lidhur me arsyet e skualifikimit

të nëpunëses në fjalë, nga konkurimi me shpalljen me kod #3625, i cili nëpërmjet shkresës përgjigje nr. 3856 prot/1, datë 05.07.2021, ka sqaruar se:

Në kuadër të zbatimit të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2021, është shpallur konkurimi për lëvizje paralele e pranim në shërbimin civil, me kod #3625, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë - Kategoria e III-b - Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/ Juridike/ Inxhinierike”; niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”.

Pas paraqitjes së aplikimeve nga kandidatët e interesuar, njësia paraseleksionuese e DAP, ka vendosur skualifikimin e aplikantes \*\*\*\*\*, duke bërë dhe njoftimin përkatës për këtë vendim. Ankuesja e ka konsideruar të padrejtë skualifikimin e saj, pasi ajo zotëronte arsimin e kërkuar dhe kishte një eksperiencë të mjaftueshme për të qenë pjesëmarrëse në këtë konkurim, prandaj ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit, për rivendosjen e të drejtës së saj.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimit të kryer nga nga njësia përgjegjëse në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III “Proçedura paraprake”, të Rregullores “Mbi proçedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua dokumentacioni i dërguar, prej nga rezultoi e vërtetuar se:

Nëpunësja \*\*\*\*\*, është nëpunës civil në pozicionin “Specialisti Funksioneve të Deleguara në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara” në Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë, dhe ka shprehur interes për të konkuruar në shpalljen me kod #3625, për lëvizje paralele e pranim në shërbimin civil, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë – Kategoria III-b.

Në përmbajtjen e aktit të shpalljes së konkurimit, kërkohet që kandidatët duhet të zotëronin Diplomën e Nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional” të përfutur në fund të studimeve të Ciklit të Dytë, me 120 kredite, dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/ Juridike/ Inxhinierike, si dhe diploma e “Nivelit Bachelor”, duhet të jetë në të njëjtën fushë.

Njësia përgjegjëse, pasi ka verifikuar dokumentacionin që shoqëron aplikimin e kandidatës \*\*\*\*\* dhe ka konstatuar se ajo zotëron Diplomë në Agronomi të Përgjithshme dhe Diplomën e Nivelit Master Shkencor në Mësuesi për Biologji dhe Kimi, kualifikime këto të cilat nuk përfshihen në fushën e Shkencave Juridike/ Ekonomike/ Inxhinierike, ashtu siç është përcaktuar në shpalljen me kod #3625, ka vendosur skualifikimin e saj, duke bërë dhe njoftimin përkatës.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në

mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të njësisë përgjegjëse për skualifikimin e konkurrentes \*\*\*\*\* , nga pjesëmarrja në konkurrimin e shpallur me kod #3625, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në Administratën e Prefektit të Qarkut Lezhë – Kategoria III-b dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Prefekti i Qarkut Lezhë dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**